



RAPORTI I VLERËSIMIT TË PROBLEMETIKAVE MJEDISORE TË TERRITORIT TË BASHKISË DIVJAKË



Horizont EU - 2022



Ky raport u përgatit nga eksperti ligjor dhe institucional: Agim Hajdari

Grupi ndihmës për përgatitjen e raportit

Shkelqim Bylykbashi, kryetar i HEU

Ermir Kasmi financier HEU

Fadil Malko specialist MEN

Aurel Sharka punimi grafik

Mirënjohje dhe falënderime

Falenderojmë anëtarët e rrjetit “Vendi Ynë e Ardhmja e Fëmijëve Tanë” (VYAFT), të gjithë ata bashkëpunëtorë, të cilët dhanë kontributin e tyre në hartimin e këtij raporti, personat dhe strukturat që ushtrojnë përgjegjësitë institucionale e ligjore në mbrojtjen e promovimin e burimeve natyrore në Parkun Komëtar Divjakë – Karavasta (PKDK), në veçanti bashkëpunëtorët e rrjetit VYAFT zonës së mbrojtur Kune Vain Tale për shërbimet që ai ofron. Falenderojmë gjithashtu stafin e AdZM, Bashkinë Divjakë, Këshillin Bashkiak Divjakë. Një falënderim të veçantë për Administratoret e NjA dhe shkollat e mesme në 5 NjA ku përfshimë qytetarët për analizimin e situatës mjedisore në territoret e tyre si dhe plotësimin e pyetesoreve.

Date 20 qershor 2022

Shkurtesa

AdZM	Administrata e Zonave te Mbrojtura
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të TerritoritAKZM Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
BD	Bashkia Divjakë
BE	Bashkimi Evropian
DRM	Drejtoria Rajonale e Mjedisit
DRrR	Drejtoria e Rrugeve Rurale Bashkia Divjakë
DSHP	Drejtoria e Sherbimeve Publike Bashkia Divjakë
SVMP	Sektori i Veterinarise, Mjedisit dhe Pyjeve Divjake
DBMU	Drejtoria e Bujqesisë, Mjedisit dhe Ujitjes Bashkia Divjakë
DEC	Drejtoria e Emergjencave Civile Bashkia Divjakë
INCA	Instituti për Mbrojtjen e Natyres, Shqiperi
IKMT	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
IVMT	Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes se Territorit
HEU	Horizont EU Lushnjë
KM	Këshilli i Ministrave
VKM	Vendim i Keshillit te Ministrave
KUZ	Kanalizimet e Ujërave të Zeza
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
VYAFT	Rrjeti “Vendi ynë e ardhmja e fëmijëve tanë” .
MZSH	Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi
SMMTA	Sektori i Menaxhimit Mbrojtjes Tokes dhe Aseteve
Nj.A	Njësia Administrative
OMP	Organizata te Menaxhimit te Peshkimit
OJF	Organizata Jofitimprurëse
OJQ	Organizata Joqeveritare

OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
DPZHT	Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit
APGJ	Agjensia e Pastrimit dhe Gjelberimit
PMZM	Plani i Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
PVM	Plani i Veprimit në Mjedis
SA	Strategjia e Advokimit
Sh.a.UKD	Shoqëri Aksionere, Ujësjetes Kanalizime Divjake
ZVAP	Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar

Përmbledhje Ekzekutive

Në Bashkinë Divjakë janë raportuar tre depozitime (hot spote Gur, Gradisht dhe Grabian). Ndërkohë, vend depozitimi i Tërbufit i përmendur në studimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit raportohet i mbyllur (DLDP & MoTE, 2018). Pamvaresisht kesaj nga kontaktet ne terren si dhe gjate plotesimit te pyetesorit banore te njesise Terbuf shprehen shqetesimin se nga kjo pike e "mbyllur" here pas here vjen tym dhe ere e rende pasi digjen plehra te cilat ne pamundesi per ti menaxhuar punonjesit e bashkise i grumbullojne aty dhe ju vene flaken.



Vend-depozitimi Tërbuf, Bashkia Divjakë

Asnjë nga këto depozitime nuk i plotëson kriteret dhe standardet teknike ligjore. Vend-depozitimi i vendosur në fshatin Gur u miratua me vendim të Këshillit të ish-Komunës Remas, Nr. 90, datë 10.03.2014. Për këtë vend-depozitim (me një sipërfaqe prej 3,500 m²) është aplikuar për leje mjedisi, e cila është refuzuar. Duhet të konsiderohet se vend-depozitimi i fshatit Gur është brenda zonës së mbrojtur të shpallur me VKM nr. 687, datë 19.10.2007 "Për zgjerimin e Parkut Kombëtar të Ekosistemit Natyror" Divjake-Karavasta "(DLDP & MoTE, 2018). Në këtë mënyrë, depozitimi duhet të mbyllet sa me pare dhe të rehabilitohet sepse është vendosur midis dy kodrave të peisazhit me prani të ujrave sipërfaqësorë të cilat kalojnë përmes vend-depozitimit dhe derdhen në lagunën e Karavastasë. Mbetjet urbane janë të depozituara në lartësi, pranë një sipërfaqe pyjore duke krijuar ndotje dhe për pyllin. Shllami i prodhuar nga mbetjet janë burim i ndotjes derisa ato zbresin në lagunën e Karavastasë përmes kanaleve të kullimit.

Vend-depozitimi Grabian, ndodhet në Rrugën Grabian-Ferras me një sipërfaqe prej 1,375 m², është miratuar me Vendimin e Këshillit të ish-Komunës së Grabianit Nr. 17, datë 23.12.2012. Depozitimi ishte i pa rrethuar dhe shumë afër shtëpive (DLDP & MoTE, 2018). Uji i ndotur derdhej në rrugë dhe përfundonte në kanalin e kullimit të tokave bujqësore. Vend-depozitimi ka pasur mungesë të infrastrukturës ndihmëse për një vend-depozitim



Vend-depozitimi Gur, Bashkia Divjakë Burimi: Bashkia Divjakë

Vlerësohet se edhe për këtë sipërfaqe e cila është mbyllur tashmë dhe nuk shërben si vend-depozitim për mbetjet, është e nevojshme të ndërhyet me investime për rehabilitim, pasi mbetjet e depozituara prej vitesh dhe të mbuluara me dhe janë pikë e nxehtë mjedisore për dëmet që vazhdon të shkaktojë.

Depozitimi i Gradishtes është larg qendrave të banuara ky depozitim është miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë nr. 50, datë. 27.10.2008. Për të ndërtuar këtë vend-depozitim, Bashkia Divjakë aplikoi për një leje mjedisore, por Ministria e Turizmit e refuzoi. Depozitimi ka një sipërfaqe prej 1,000m² pa rrethim apo sinjalistikë dhe nuk përmbush kushtet minimale (DLDP & MoTE, 2018). Nga Agjencia e Pastrim Gjelbërimit në Bashki vlerësohet se në këtë vend depozitim dergohet një sasi e vogël e mbetjeve. Bashkia nuk ka një vend-depozitim të dedikuar për mbetjet inerte dhe vlerësohet se edhe ato pak mbeturina inerte që gjenerohen, përdoren për të mbushur rrugët bujqësore por dhe rrugët në ndërtim. Nga vëzhgimi në vend-depozitimet e mësipërme vërehet se ka veprimtari joformale për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme. Nga sa vihet re nga analiza e mësipërme, rezulton se asnjë nga vend-depozitimet në funksion nga Bashkia Divjakë nuk është në kushtet për të vazhduar aktivitetin pasi nuk plotësojnë kushtet dhe standardet minimale mjedisore duke krijuar ndotje dhe rrezik mjedisor për zonat e mbrojtura dhe tokat bujqësore të cilat janë në masë të madhe prezente në territorin administrativ. Për këtë qëllim duke ju referuar edhe dispozitave ligjore, konkretisht ligji Nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, neni 45, pika 3, gjatë realizimit dhe zbatimit të këtij plani duhet të merret në konsideratë planifikimi i një pike tranzitore për grumbullimin provizor të mbetjeve, ku mund të realizohet dhe një ndarje/selektim i mbetjeve të riciklueshme për të ulur kostot e transportit dhe depozitimit në landfillin/incineratorin rajonal Fier.

Kapitulli 1. Hyrje

1.1 Konteksti i Përgjithshëm

Parku Kombëtar Divjake – Karavasta (PKDK) është një nga zonat e mbrojtura ku ka një larmi e diversitet të spikatur të burimeve natyrore si dhe në territorin e bashkisë Divjakë. Prezenca e një zone të mbrojtur pjesë apo problemet me të cilat përballë një administratë në nivel vendor siç është bashkia Divjake janë përgjegjësi dhe përfitim njëherazi! Ruajtja dhe promovimi i burimeve natyrore apo pasurive kombëtare me status të vecantë, janë vlera që duhen trashëguar tek brezat e rinj. Realizimi i këtij misioni kërkon angazhimin e qytetarëve, administratës publike si dhe të shoqërisë civile e grupeve të interesit. Evidentimi i problemeve në nivel lokal lidhur me ruajtjen dhe menaxhimin e pasurive natyrore kërkojnë një angazhim të kordinuar të OJF-ve në vecanti, të shoqërisë në tërësi, grupeve të interesit ku në fokus të jetë bashkëpunimi për aktivitete advokuese dhe lobuese mbi proceset demokratike të vendimmarrjes lokale por jo vetëm, me fokus mbrojtjen dhe promovimin e këtyre burimeve si dhe përfitimi në aspektin ekonomik në rastet kur kjo është e mundur pa demtuar pasuritë natyrore.

Raporti i vlerësimit të problemeve të territorit të bashkisë Divjakë, hartohet nga HEU, partner i INCA-s, në kuadër të projektit "Rrjetëzim dhe Advokim për Aksione Komunitare të Ruajtjes së Burimeve Natyrore Lokale", me mbështetjen financiare të Leviz Albania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC.

Projekti "Rrjetëzimi dhe Advokim për Aksione Komunitare të Ruajtjes së Burimeve Natyrore Lokale" po zbatohet në Bashkinë e Divjakës me fokus Mbrojtjen e Natyrës dhe Pasurive Kombëtare nepermjet rrjetit "Vendi yne e ardhmja e femijeve tane".

Raporti hartohet nga HEU si pjesë e rrjetit të rivitalizuar lokal "Vendi Yne e Ardhmja e Femijeve Tane", me pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile Lushnjë e Divjake si dhe të medias, çka e bën produkt të rëndësishëm të bashkëpunimit mes tyre.

Hartimi i këtij projekti është bërë në bashkëpunim me Institucionet e Agjencitë ligjzbatuese që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë së Divjakës e që kanë lidhje direkte apo indirekte me administrimin e burimeve natyrore si DT, DBUAP, AdZM, ARM, AKBD, IVMT, etj si dhe organizatat të tjera të shoqërisë civile.

Për realizimin e raportit jemi referuar e konsultuar në dokumentat zhvillimore e strategjik në nivelin e QL e të BD.

Raporti hartohet pasi janë evidentuar e vlerësuar problematikat aktuale që lidhen me situatën mjedisore në terren, marrë nga opinionet e të anketuarve dhe që lidhet me administrimin e burimeve natyrore në territorin e Bashkisë Divjakë, në raportin që kanë institucionet mes tyre vecanerisht në zonën së mbrojtur të PKDK, maredheniet ligjore e

institucionale të gjithë aktorëve vendas e më gjërë dhe përcaktimin e një strategjie advokimi në vazhdim në lidhje me keto çështje.

Ky raport ka si qëllim kryesor që t'i shërbeje rrjetit si dhe të gjithë aktorëve lokal rajonal e më gjërë, të interesuar për mbrojtjen dhe promovimin e burimeve natyrore, për të kontribuar në ndërtimin e një komuniteti aktiv, partner e te pefshire në procesin e qeverisjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm në Bashkinë Divjakë.

Qëllimi i këtij raporti është të nxisë programe afatgjatë bashkepunimi për advokim në përdorimin e qëndrueshëm të pasurive natyrore në nivel rrjetezimi lokal e kombëtar.

Raporti ka si objektiva specifike:

- Evidentimin dhe vlerësimin e problematikave të mjedisore e që lidhën ngushtë me administrimin e burimeve natyrore lokale e që adresojnë zhvillimin e qëndrueshëm të BD si dhe sa është i integruar menxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore lokale me zbatimin e politikave në këtë nivel.
- Përcaktimin e institucioneve përgjegjëse, detyrimet ligjore dhe kapacitetet reale për zbatimin e tyre.
- Orientimin në hartimin e planit strategjik të advokimit (watchdog) për çështjet e menaxhimit të pasurive natyrore e të mjedisit në tërësi për periudhën në vazhdim.

Raporti është hartuar në 6 mujin e parë të vitit 2022

1.2. Baza Ligjore

1.2.1 Ligji për vetëqeverisjen vendore

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", njesitë e vetëqeverisjes vendore, Bashkitë, janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes", (neni 16), ku specifikohet (pika 2 e këtij neni) se "Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik". Në këtë kuader qëndron dhe mundësia dhe hapesira e bashkëpunimit të OSHC dhe Bashkisë.

Po ashtu, OSHC mund të marrin pjesë në Mbledhjen e Keshillit Bashkiak, pasi ato janë të hapura për publikun (Neni 17, pika 1). OSHC kanë një spekter të gjërë çështjesh në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, ku mund të mbështesin bashkëpunimin dhe aksionin në realizimin e objektivave të saj, pasi bazuar në këtë ligj, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për (neni 23, në vijim të lidhuar direkt me mjedisin):

- Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm.

- Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.
- Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmytjet në zonat e banuara.
- Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike.
- Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.

Bashkëpunimi mes OSHC-ve dhe NjV garantohet me ligj pasi keto të fundit, janë përgjegjëse direkte në mbrojtjen e mjedisit për kryerjen e funksioneve (neni 26):

1.2.1 Ligjet Sektoriale

Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit" me amendimet përkatëse, ka qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Ky ligj është përafshuar plotësisht me Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 21 Prill 2004 "Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin" e ndryshuar; Në këtë Ligj specifikohet se Kryetarët e njësisë të qeverisjes vendore, në fillim të çdo viti, raportojnë në këshillin e qarkut për zbatimin e planeve vendore përkatëse për mjedisin, për vitin pararendës(Neni 22).

Mbrojtja e natyrës dhe parimet e përgjithshme, garantohen edhe nëpërmjet ligjit të sipercituar (në nenin 5) në të cilin është përcaktuar se "ruajtja e shumëllojshmërisë biologjike" është një prej elementeve të mjedisit.

Ka disa akte ligjore që garantojnë mbrojtjen e natyrës në Republikën e Shqipërisë, nga të cilat mund të përmendim:

Ligji "Për mbrojtjen e Biodiversitetit" i ndryshuar, synon të sigurojë mbrojtjen dhe ruajtjen e diversitetit biologjik, të rregullojë përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të diversitetit biologjik, nëpërmjet integritit të elementeve kryesore të biodiversitetit në strategjitë, planet, programet dhe vendimmarrjet e të gjitha niveleve, të sigurojë ngritjen e rrjetit për ruajtjen e habitateve natyrore dhe florës e faunës së egër në territorin e Republikës së Shqipërisë. Po ashtu ky ligj synon të përcaktojë masa për të mbajtur ose rivendosur në një status të favorshëm ruajtjeje habitatet natyrore dhe llojet e faunës së egër të Shqipërisë dhe me interes për Komunitetin Europian, të sigurojë që masat e ndërmarra, në zbatim të këtij

ligji, të marrin në konsideratë kërkesat ekonomike, sociale dhe kulturore, si dhe karakteristikat rajonale.

Ligj nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura", ka për objekt shpalljen, ruajtjen, administrimin, menaxhimin, përdorimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura mjedisore dhe të burimeve të tyre natyrore e biologjike, në bazë të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm, për të garantuar përmbushjen e funksioneve mjedisore, ekonomike, sociale e kulturore, në interes të të gjithë shoqërisë, si dhe përcaktimi i përgjegjësive të institucioneve publike dhe personave fizikë/juridikë privatë për ruajtjen dhe administrimin e qëndrueshëm të tyre.

Ligji nr. 111/2012, datë 15.12.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" i ndryshuar, ka si qëllim mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, të ujërave sipërfaqësore, qofshin të përkohshme apo të përhershme, të ujërave të brendshme detare, të ujërave territoriale, zonave ekonomike ekskluzive, shelfit kontinental, të ujërave ndërkufitare, të ujërave nëntokësore, si dhe të statusit të tyre;

Ligj nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, ka si qëllim:

- a) të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore;
- b) të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillimin e territorit në nivel kombëtar e vendor, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publikë e privatë, duke bashkërenduar punën për mbrojtjen e burimeve natyrore, si: toka, në veçanti toka bujqësore, ajri, uji, pyjet, flora, fauna, peizazhet;

Ligji nr.10440 datë 7.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" me ndryshimet përkatëse, specifikon dhe përcakton kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme negative në mjedis të projekteve të propozuara, private apo publike cilët janë, projektet që i nënshtrohen, përgjegjësitë e palëve në proces, mënyrën e miratimit të lejes mjedisore; Ne këtë ligj specifikohet përfshirja në procesin e

VNM e Njesise se Qeverisjes Vendore, Publikut dhe OJF, (Neni 14), informimi i publikut gjate procesit te VNM-se (Neni 16), dhe seanca degjimore (Neni 17) ".....njësia e qeverisjesvendore bën njoftimin drejtuar publikut dhe OJF-ve të interesuara për të marrë pjesë në takim".

Ligji nr.10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar, përcakton rregullat e përgjithshme për menaxhimin e integruar të mbetjeve, përfshirë parandalimin ose pakësimin e ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i tyre, përmes pakësimit të përdorimit të burimeve dhe përmirësimin të efikasitetit të këtij përdorimi;

Ky ligj është përafuar plotësisht me Direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008 "Mbi mbetjet", Në këtë ligj specifikohet se "Sistemi i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve është optimizimi i të gjitha aktiviteteve të menaxhimit të integruar të mbetjeve, duke marrë në konsideratë grupet e interesit, elementet e menaxhimit të integruar të mbetjeve, si dhe aspektet e menaxhimit të qëndrueshëm, për të promovuar teknikat më të mira të disponueshme, ekonomikisht të zbatueshme dhe të pranueshme nga ana sociale, pa degraduar mjedisin;

Konventa "Per te drejten e Publikut per informacion, pjesmarrje ne vendim marrje dhe te drejten per t'ju drejtuar gjykates, per çeshtje qe lidhen me mjedisin" (Aarhus). 25 Qershor 1998 Danimarkë

Ligji 8672 date 26.10 200 "Per ratifikimin e "Konventes së Aarhusit për të drejten e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit".

VKM nr. 994, 2.07.2008 "Per terheqjen e mendimit te publikut ne vendimmarrje për mjedisin" synon pjesmarrjen e publikut në hartimin e politikave, të strategjive rajonale e kombëtare, të përgjithëshme e sektoriale, dhe të planeve të veprimit në zbatim të tyre, që kanë lidhje me mjedisin, përbën kërkesë ligjore në procesin e hartimit të këtyre dokumenteve, që përmirson përmabajtjen dhe lehtëson zbatimin e tyre.

1.3 Metodologjia e Punës për vlerësimin e problematikave lokale

1- Përshkrim i situatës mjedisore në bashkinë Divjake

Gjendja mjedisore në bashkinë Divjake nuk është aspak e mirë. Numri i personave të pyetur dhe problemeve të dala referuar kapaciteteve njëzore që posedon bashkia dhe angazhimit të tyre nuk justifikohet gjendja në njesitë administrative si dhe pronat publike në përdorim të saj apo në pronësi. Shkak për këtë janë disa arsye të cilat po i rëndisin si më poshtë!

a - Krijimi i një vend depozitimi të vetëm të mbetjeve urbane në fshatin Gur pranë Lagunes së Karavastase nuk e justifikon pamundësinë e menaxhimit të mbetjeve nga ana e BD.

b - BD duhet të kishte filluar të orientonte dhe keshillonte fermeret e saj drejt një bujqësie organike apo të qëndrueshme pa krijuar kontaminim të tokës dhe ujërave në mënyrë që fermeret do të kishin një qasje më të afërt për Agro-turizmin. c

– reagimi i dobët komunitar ndaj vendimit të BD sa i përket demit që shkakton në lagune kalimi i ujërave të dala nga mbetjet, ndotja e burimeve ujore dhe mjedisit në Zonën e Mbrojtur.

2- Përshkrim mbi njohjen e kuadrit ligjor në nivel të bashkisë dhe komunitetit lokal

Kuadri ligjor është thujtë i panjohur fare si nga punonjësit e bashkisë po ashtu edhe nga anketuesit të cilët nuk kanë dijeni nëse ka një plan. Pyetjes “Në dijeninë tuaj sa e rëndësishme është ruajtja e mjedisit natyror në bashkinë tuaj?” pjesa më e madhe e anketuesve i përgjigjen se është shumë e rëndësishme ose e rëndësishme. Pyetjes në vijim “Në dijeninë tuaj a ka plan veprimi për mjedisin të miratuar në bashkinë tuaj?” që ka lidhje logjike të pashmangshme me pyetjen më sipër anketuesit dalin të gjithë zbuluar pasi nuk kanë asnjë informacion por vetëm hamendesojnë dhe përpiqen të ruajnë bashkinë duke dhënë përgjigje vlerësuese çka i nxjerr zbuluar nga pyetjet në vazhdim. Në gjykimin përfundimtar kuadri ligjor është shumë pak i njohur si nga administrata po ashtu edhe nga nivelet e tjera të komunitetit.

3- Problematikat mjedisore të identifikuar dhe përshkrimi pse është përzgjedhur si problem mjedisor

- a) Mbetjet urbane dhe djegja e tyre në vendgrumbullimet e riaktivizuara apo funksionale është një nga shqetësimet më të mëdha të gjithë banorëve të bashkisë Divjake!
- b) Ujrat e zeza dhe mungesa e kanalizimeve dhe impianteve të përpunimit të tyre janë një tjetër shqetësim i shprehur nga banorët e bashkisë Divjake.
- c) Peshkimi dhe gjithë shqetësimet që krijon mosfunksionimi i këtij sektori si nga ana organizative po ashtu edhe nga ana funksionale ku gjuetia e paligjshme dhe mosrespektimi i sezonit dhe madhësia e peshkut duke demtuar edhe rasatin.
- d) Laguna e Karavastase e cila ka degraduar në një gjendje goxha të vështirë sa i përket funksionimit të saj natyror për shume arsye të lidhura me njeriun, nderhyrjen apo ndikimin e tij nga mosveprimi si detyrim ligjor. Vend grumbullimi i mbetjeve urbane në fshatin Gur është një vater e kuqe për sa i përket ndotjes në lagunen e Karavastase. Të gjithë ujrat nga ky vend grumbullim shkojnë direkt në lagune duke kontaminuar ujrat e saj.
- e) Përdorimi i plehrave kimike dhe pesticideve në bujqësi. Bujqësia intensive është një tjetër problem në këtë bashki sidomos në zonat pranë PKDK, pasi përbejnë rrezik për kontaminimin e zonës së parkut. Duhet që fermeret të jenë të prirur drejt një bujqësie sa më organike.

4 - Problemet më prioritare duke menduar se si në si rrjet lokal VYAFT mund të adresojmë janë:

- Mbetjet urbane në fshatin Gur pranë lagunes së Karavastase,
- Përdorimi i pesticideve në zonat bujqësore të Parkut Kombëtar Divjake-Karavasta

- Peshkimi pa kriter ne lagunen e Karavastase.
- Djegia e mbeturinave ne njesine Terbuf.

5- Rekomandimet tona per menyren e adresimit te ketyre problemeve duke cilesuar sa kapacitete kemi dhe cili eshte suporti i nevojshem qe na nevojitet ne kete proces advokimi

BD duhet te kete nje kordinim te mire me te gjitha aktoret lokale si OJF-te, grupet e interesit, operatoret turistik por ne vecanti banoret si perfituesit dhe partneret me te mire ne cdo nisme me karakter komunitar e aq me teper me baze vullnetare por jo vetem. Situatat mjedisore qe mund dhe duhet te ndryshojne jane te lidhura me realitetin e perditshem qe kryen cdo qytetar qofte ky fermer, peshkatar, nxenes apo pensionist si dhe punonjesit e administrates se cdo niveli.

Rrjeti lokal VYAFT duke patur ne perberje perfaqesues nga te gjitha keto shtresa beson se me pune gjithepershiresore mund ta permiresoje kete realitet aspak te pranueshem.

Fushata edukimi ne nivel komuniteti dhe sistem arsimor (shkolla) perfshi median dhe rrjetet sociale, shoqeruar me fushata advokimi ne nivel administrate lokale por edhe lobimi ne linje ministrish te linjes do te sjelle nje tjeter panorame. Kjo eshte e sigurt sepse na jep suport komuniteti dhe aktoret e tjere lokale, ata qe jane me te interesuarit per ta permiresuar kete situatete te rende mjedisore sepse ka ndikim te drejtperdrejte ne jeten dhe bizneset e tyre te perditeshme.

Bashkia Divjake njeherazi duhet te kete bashkeveprim me intensiv dhe frytdhenes me Ministrine e Mjedisit dhe Turizmit, si dhe Administraten e Zonave te Mbrojtura te Qarkut Fier per mbrojtjen e mjedisit ne territorin e saj.

Gjithashtu bashkia duhet te advokojte me Ministrine e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural per te zgjidhur problemet ne Lagunen e Karavastase qe nuk duhet harruar eshte laguna me e madhe dhe me e rendesishme ne vendin tone. Gjithashtu kjo lagune eshte pjese e Konvetes RAMSAR qe prej vitit 1995 dhe ndaj duhet nje pune e mire kordinuar me te gjitha institucionet, shoqatat mjedisore dhe banoret e zones per te mbrojtur degradimin e kesaj pasurie te madhe per te gjitha rajonin.

Rrjeti lokal VYAFT duke patur ne perberje perfaqesues nga te gjitha keto shtresa beson se me pune gjithepershiresore mund ta permiresoje kete realitet aspak te pranueshem.

Fushata edukimi ne nivel komuniteti dhe sistem arsimor (shkolla) shoqeruar me fushata advokimi ne nivel administrate lokale por edhe lobimi ne linje ministrish te linjes do te sjelle nje tjeter panorame. Kjo eshte e sigurt sepse na jep suport komuniteti dhe aktoret e tjere lokale, ata qe jane me te interesuarit per ta permiresuar kete situatete te rende mjedisore sepse ka ndikim te drejtperdrejte ne jeten dhe bizneset e tyre te perditeshme.

Bashkia Divjake njeherazi duhet te kete bashkeveprim me intensiv dhe frytdhenes me Ministrine e Mjedisit dhe Turizmit, si dhe Administraten e Zonave te Mbrojtura te Qarkut Fier per mbrojtjen e mjedisit ne territorin e saj.

Gjithashtu bashkia duhet te advokoje me Ministrine e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural per te zgjidhur problemet ne Lagunen e Karavastase qe nuk duhet harruar eshte laguna me e madhe dhe me e rendesishme ne vendin tone. Gjithashtu kjo lagune eshte pjese e Konvetes RAMSAR qe prej vitit 1995 dhe ndaj duhet nje pune e mire kordinuar me te gjitha institucionet, shoqatat mjedisore dhe banoret e zones per te mbrojtur degradimin e kesaj pasurie te madhe per te gjithe rajonin.

Kapitulli 2. Konteksti lokal, Bashkia Divjakë

2.1 Pozicioni Gjeografik

Zona Gjeografike: Bashkia e re Divjakë kufizohet në veri me bashkinë Rogozhinë, në lindje me bashkinë Lushnjë, në jug me bashkinë Fier dhe në perëndim me Detin Adriatik. Kryeqendra e bashkisë së re do të jetë qyteti i Divjakës, i shpallur qytet me vendim qeverie në vitin 1996.

Bashkia Divjakë përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Divjakë, Tërbuf, Grabjan, Gradisht dhe Remas. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Lushnjes dhe qarkut Fier. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 36 fshatra.

2.2 Popullsia

Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e Divjakës numëron një popullsi prej 34.254 banorësh ndërkohë që në regjistrin civil rezulton një popullsi 53.372 vetë. Territori i bashkisë së re është 309.58 kilometra katrore. Në bazë të censurit, densiteti i popullsisë është 110 banorë për kilometër katror ndërsa në bazë të regjistrit civil densiteti është 172.40 banorë/km².

Kjo bashki përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Divjakë, Tërbuf, Grabjan, Gradisht dhe Remas. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Lushnjes dhe qarkut Fier. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 36 fshatra.

Veçantia për këtë Bashki është fakti se ka një ndryshim të madh në numrin e njerëzve që jetojnë gjatë periudhave të ndryshme të vitit. Nga konstatimet e banorëve, rezulton se shumë shtëpi përdoren vetëm gjatë sezonit të verës. Nga ana tjetër ky fakt është vlerësuar me një numër prej 320,000 turistësh/vit. Kapacitetet turistike janë të kufizuara dhe kohët e fundit ka pasur investime në hotele dhe komplekse turistike, të pajisura me infrastrukturë të përshtatshme, të cilat lejojnë edhe kryerjen e shërbimeve publike.

2.3 Zhvillimi Sociol – Ekonomik

Bashkia e Divjakës është nga të paktat bashki të krijuara nga reforma administrative dhe territoriale e cila përbëhet pothuajse tërësisht nga zona rurale. Bashkia e re ka një shtrirje veri-jug ndërkohë që rrugët janë më së shumti në drejtimin lindje-perëndim dhe lidhja rrugore mes qytetit të Divjakës dhe komunave Gradishtë e Rremas është e dobët.

Bashkia e re ka aktivitet kryesor ekonomik bujqësinë dhe në një masë më të vogël peshkimin në lagunën e Karavastasë. Prodhimi kryesor bujqësor janë bostanoret, të cilat shiten në tregun e brendshëm si dhe eksportohen në shumë vende të Europës qendrore dhe lindore. Turizmi është zhvilluar më së shumti për turistët ditorë dhe kulinaria është e përqendruar te prodhimet e peshkut, për të cilat zona është e famshme në të gjithë vendin.

2.4 Infrastruktura

Njesite e qeverisjes vendore, për qëllime planifikimi, ndahen në sisteme territoriale të cilat listohen si më poshtë:

- -Sistemi Urban (U B)
- -Sistemi Natyror (N)
- -Sistemi Bujqësor (B)
- -Sistemi Ujor (U)
- -Sistemi Infrastruktural (IN)

Ndarja mes sistemeve në realitet, është shumë më e sfumuar se sa mund të duket në letër. Për shembull hapësira e nevojshme për ndërtimin e industrisë përpunuese të produkteve të sektorit primar (bujqësi) i përket sistemit urban, por funksionimi i saj do të rrisë efikasitetin e prodhimit bujqësor. Ndërtimi i impianteve të Ujrave të Zeza I përket sistemit infrastruktural, por ai ka një impakt të madh në përmirësimin e cilësisë të ujërave, të natyrës dhe të zonave urbane. Territori i Bashkisë, ka pasur një ndryshim të ndjeshëm të sistemeve gjatë 25 viteve të fundit, veçanërisht zgjerimi i zonave urbane në dem të sistemit bujqësor e natyror. Zhvëlimi i planifikuar – Strategjia Territoriale, bazuar si në planet kombëtare ashtu dhe në dinamikën lokale ka një riqasje polivalente gjithëpërfshirëse, duke synuar një balancim të sistemeve urbane dhe harmonizim të zhvillimit urban me zhvëllimin rural e turistik.

Sistemi urban

Aktualisht zonat urbane (Sistemi Urban), kanë një shtrirje të madhe por një dendësi të ulët të banorëve dhe një shtetshëm të bonimit. Kategorizimi i vendbanimeve si qytet qendra lokale dhe fshatrat, do të diversifikojnë dhe tipologjinë e ndërtimit krahas dendësive të banorëve. Sistemi urban: do të konsolidohet dhe do të pasurohet me zona të reja kryesisht të orientuara drejt ekonomisë dhe turizmit por dhe brenda zonave urbane ekzistuese do të ketë rishtrukturime dhe blloqe të reja, për të mundësuar knjimën e qendrave arsimore, sociale, komunitare dhe rekreative.

Pjese e Sistem Urban, jane dhe zonat ekonomike: zonot e grumbullimit, perpunimit, tregtimit dhe sherbimeve mbeshtetese. Keto zona per vete funksionin e tyre duhet te jene lehtesisht te aksesueshme dhe jo prone vendbanimeve per te mos ndikuar ne skemat e trofikut dhe ne ndojen potenciale. Zhvillimi i ketyre zonave mund te ndikojne ne transformime te sistemit bujqesor.

Zhvillimi i turizmit eshte i pashmangshem ne nje territor me potencial te forte si detar ashtu dhe rural e natyror. Zhvillimi i turizmit do te bazohet ne zona ekzistuese por dhe ne zona te reja. so, t pjese te sistemit natyror e bujqesor.

Sistemi infrastrukturor

Sistemi infrastrukturor i Bashkise Divjoke, ze nje siperfaqe prej 416 ha. Ne nivei bashkie vihet re kryesisht prezenca e rrugeve lokale. te rrugeve urbane kryesore e dytesore kryesisht ne qendren e qytetit Divjake dhe ne fshatin Grabjan. Nderkohe ne fshatrat kodrinore dhe ato jugore aksesu eshte i ulet. ku dominojne rruget e paosfaltuara. Sistemi infrastrukturor eshte baza e te gjitha lidhjeve dhe mundesuesi i funksionimit optimal te territorit te urbanizuar. Ky sistem eshte lene ne pian te dyte ne 25 vitet e fundit dhe strategjia synon nje rimekembje totale te tij. Ky rivitalizim i infrastrukturave do te thote nje rehabUitim te hapësirave ekzistuese por dhe nje zgjerim i keflj sistemi ne drejtim te sistemeve te tjera. **Sistemi infrastrukturor**, eshte sistemi qe ka nevojte per me shume nderhyrje ne krijim aksesh. Sistemim lidhjesh, zgjerim dhe reabilitim.

Sistemi natyror

Territori i bashkise Divjake ko nje siperfoqe prej 7187 ha. qe 1 perket sistemit natyror. 1 shtrire ne pjesen lindore ne lartesine e kodrave dhe gjithashtu, ne pjesen perendimore mes hapësirave qe lidh zonen e plazhit me Lagunen e Divjakes, sistemi natyror perbehet nga nje shumellojshmeri habitatesh si pyje gjethegjere. halore. sklerofilet. pyjet e perziero dhe prezenca e dunave ranore. Keto elemente, perbejne nje posuri me potencial te zhvillimit te turizmit natyror dhe propozlmit te aktiviteteve mjedisore atraktive per zhvillimin e ketij sektori.

Ruajtja e mjedisit e pasurive natyrore, do te realizohet me ane te evidentimit dhe vleresimit te tyre, duke i kthyer ne parqe dhe duke organizuar fushata te medha pyllezimi. Pyllezimi do te jete nje element. qe do te gjeje zbatim ne shmangien ose zbutjen e diso problematikave si permbytja, erozioni, rehabilitimi i vendgrumbullimit te mbeijeve, krijimi i barrierave vizive dhe akustike pergjate infrastruktures kryesore, etj. Keto te fundit do te shikohen te integruara me ullishte e me vreshta dhe me mbjellje pemesh jo vetem ne afersi te tyre por

dhe ne zona ku ka erozion te larte (Tokesor dhe detar). Te gjitha keto programe do te ndikojne ne rritjen e siperfaqeve te Sistemit Natyror.

Sistemi bujqesor Sistemi bujqesor mbulon nje hapesine prej 19553 ha dhe shtrihet ne pothuajse te gjithe siperfaqen e Bashkise Divjake. qe nga kodrinat ne lindje ne fshatrat Germenj 1 Madh, Grabjan e Spolet. ne pjesen veriore ne fshatrat Sulzotaj. çerme-Shkumbin dhe çerme-Proshk. si dhe ne pjesen jugore Muçias. Remas e Gur. E gjithe zona. Ka cilesi te larte te tokes duke otruar prodhimtari te madhe te produkteve bujqesore dhe duke u kthyer ne elementin kryesor ekonomik te bashkise.

Zhvillimi i bujqesise, knjimi dhe implementimi i skemave ujites. krijimi i aksesit ne kodra, do te sjelle nje rritje te mbjelljeve te pemeve frutore. ullinjve dhe krijimin e vreshtave. Keto plantacione te reja, do te zbatohen, ashtu sikurse kane filluar te implementohen ne toka sot te pa kultivuara, ne kullota qe nuk perdoren etj. Pro gradualisht. sistemi natyror do te transformohet ne Sfstem Bujqesor. Do te kete sherbime gjithmone ne funksion te bujqesise si: magazinim, perpunim tregetim, sigurimi i sherbimeve sociale edukative dhe rekreative kryesore te vendbanimeve etj. Aplikimi i mbareshtimit te peshkut dhe krustaceve ne struga, emisare dhe ne zona kenetore, eshte nje zgjerim tjetër 1 sistemit bujqesor ne ate ujqor dhe natyror.

Sistemi Ujqor

Sistemi ujqor me nje gjatesi prej 6961 ha, perbehet nga Lumi Shkumbin, degezim I Lumit Seman, Emisaret e Terbufit dhe Myzeqese, bashke me degezimet e tyre, perrenjte e perkohshem apo te perhershem, Lagunen e Karavastait. si dhe rreth 23 km vije bregdetare. Nje sistem i pasur me potencial zhvillimi te aktiviteteve ekonomike, energjetike, te peshkimit si dhe te turizmit. Mungesa e nje sistemi mbeshtetes infrastrukturor dhe politikave mirembajtese, kane sjelle ne mos shtrytezimin me kapacitete te plote te benefiteve qe ofron ky sistem. Sistemi ujqor ne territor eshte ai me dinamikat me aktive. Mjaft nga keto dinamika nuk jane te kushtezuara nga nderhy~et njerezore, por ndikojne ne veprimtarine ekonomike te njeriut: erozioni dhe akumulimi detar, levizjet e lumenjve etj. Strategjia rekomandon, nje monitorim afatgjate dhe moso stabilizuese te mire menduara per te pasur nen kontroll kete sistem. **Sistemi ujqor** nuk do te kete ndryshime ne siperfaqe, por do t'i nenshtrohet nderhyrjeve te rendesishme infrastrukturore per pastrimin dhe evitimin e permytjeve si dhe te reabilitimit te hapesirave ujqore ne funksion te bujqesise. Ne perfundim, ne h arte n ne vijim jane reflektuar konvertimet nga njeri sistem te tjetri.

2.5 Mjedisi

2.5.1 Zonat e mbrojtura

Parku Kombëtar "Divjakë-Karavasta" Sipërfaqja totale: 22.230.2 ha.

Statusi: Park Kombëtar, Kategoria II, IUCN; miratuar me VKM nr. 687, datë 19.10.2007. Gjithashtu është pjesë e zonave Ramsar, me VKM nr. 413, datë 22.08.1994, sipërfaqe 20,000.0 ha. Zonë e rrjetit EMERALD. Zonë IBA, urdhër i ministrit të Mjedisit nr. 283, datë 10.04.2013.

Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta ndodhet në pjesën qendrore dhe bregun Perëndimor të Shqipërisë. Kufizohet në Veri, nga lumi Shkumbin, kodrat e Divjakës, në Lindje, ujëmbledhësi i Myzeqesë dhe lumi Seman, në Jug dhe në Perëndim, nga deti Adriatik.

Zona e parkut konsiderohet me vlera të veçanta për natyrën dhe biodiversitetin. Mjediset më kryesore janë: Laguna e Karavastasë, godullat përreth saj, shtretërit e vjetër dhe të rinj të lumenjëve Shkumbin e Seman; ujëmbledhësit e Tërbufit dhe të Myzeqesë; rezervuarët e bujqësisë; tokat bujqësore; pyjet përgjatë brigjeve të lumenjëve Shkumbin e Seman, pyjet me pishë mesdhetare, pyjet në kodrat e Divjakës (Gjenerukë); pemët frutore, ullishtat, vreshtat dhe agrumet.

Parkut Kombëtar është një nga zonat komplekse më të rëndësishme në Shqipëri për sa i përket biodiversitetit. Shquhet për popullata të shumëllojshme floristike e faunistike, endemike, subendemike, të rralla, të kërcënuara e të rrezikuara për zhdukje.

Vlerën ekosistemit ia shton dhe prania në të e disa bimëve endemike si: Asteri (*Aster albanicus* subsp. *paparistoi*), Salepët (*Orchis albanica* si dhe forma hibride *Orchis x paparistoi*; *Orchis albanica x O.coriophora*). Në Karavasta gjenden: Hidrokotili i rëndomtë (*Hydrocotyle vulgaris*), Fieri mashkulli (*Dryopteris filix-mas*) dhe Fieri i krojeve (*Adiantum capillus-veneris*), etj.

Pyjet halorë mesdhetare kanë një areal të kufizuar dhe takohen ndërmjet grykës së lumit të Shkumbinit e të Semanit. Kodrat e Divjakës përfaqësohen nga pyje dushku të degraduar e të trajtuar si cungishte. Pylli natyror halor mesdhetar, me pishë të egër e të butë është i vetmi i këtij lloji në vendin tonë në gjendje natyrore. Në zonën e parkut takohet një komunitet i rëndësishëm i shpendëve ujore folenizues, kryesisht të rendit të pulorëve, qukapikëve, pëllumbave, harabelëve, grabitqarëve të ditës e të natës. Janë të pranishëm 89 lloje të ndryshme që i përkasin grupeve të molusqeve, insekteve, amfibëve, zvaranikëve, shpendëve dhe gjitarëve, etj. 42 lloje i përkasin kategorive shumë të rrezikuara, duke përfshirë të rrezikuara në mënyrë kritike, të rrezikuara dhe të pambrojtura. Laguna e Karavastasë shënon

të vetmen pikë folenizimi bregdetar të Pelikanit kaçurrel (*Pelecanus crispus*), lloj i rrezikuar në rang botëror. Llojet kryesore të peshqëve janë: Ngjala, Koce, Levreku, Burdullaku etj. Në zonën e parkut mbarështrohet Buallica (*Bubalus bubalis*), e cila është lloj i mbrojtur në Shqipëri.

Parku konsiderohet si zonë më rëndësi për shpendët dhe një nga zonat potenciale me status të veçantë ruajtjeje. Zona e parkut është vlerësuar edhe si zonë e rrjetit Emerald, sipas Konventës së Bernës, "Për Konservimin e jetës së egër dhe habitateve natyrore të Evropës" apo dhe zonë Ramsar.

Parku përshkohet nga duna ranore bregdetare si pranë dhe në brëndësi. Dunat e brezit ranor përgjithësisht janë të zhveshura nga bimësia, kryesisht ato që ndodhen më pranë vijës bregdetare, ndërsa dunat që u afrohen formacioneve pyjore mbuloohen me llojet bimore. Laguna e Karavastasë është më e madhja dhe më e rëndësishmja e bregdetit Adriatik, së bashku me godullat e tjera, të krijuara në këtë zonë. Laguna rrethohet dhe nga disa diga artificiale, të cilat e ndajnë lagunën nga

fushat e bonifikuara. Ekzistojnë dhe dy kanale të mëdhenj që ndajnë tokat bujqësore në brëndësi të zonës së Karavastasë, duke anash kaluar lagunën. Laguna e Karavastasë komunikon me detin nëpërmjet tre kanaleve.

Në kulturat bujqësore që kultivohen dhe prodhohen përfshihen: drithërat, patatet, drurët frutorë, ullirit, vreshtat si dhe produktet e blegtorale, etj, të cilat plotësojnë nevojat e konsumit vendor si dhe sigurojnë një pjesë të konsiderueshme furnizimi në nivel kombëtar. Peshkimi është një veprimtari e rëndësishme dhe një burim i rëndësishëm të ardhurash për komunitetin.

Parku dhe zona rreth tij ka vlera historike, kulturore, arkeologjike me potenciale të mëdha për zhvillimin social-ekonomik dhe të ekoturizmit.

PK "Divjakë-Karavasta" menaxhohet dhe trajtohet nga AKZM, nëpërmjet AdRZM, qarku i Fier. Për këtë RNM është hartuar plani i menaxhimit, i cili është miratuar me urdhrin e ministrit të Mjedisit nr. 782, datë 30.12.2015

2.5.2 Lumenjtë



Shkumbini renditet ndër lumenjtë më të rëndësishëm të Shqipërisë. Gjatësia e tij është 181km dhe sipërfaqe pellgu 2444km². Shkumbini formohet nga bashkimi i dy përrrenjëve të vegjël të cilët rrjedhin nga shpatet lindore të masivit malor të Valmarës dhe të Kamjes. Prerjet mesatre vjetore arrijne ne 61 m³/s. Grykëderdhja e tijë është në detin Adriatik, në pjesën veriore të lagunës së Karavastasë. Qysh nga viti 1990, monitorimi i ujit ka qënë shumë më pak frekuent. Rrjedhimisht, cilësia e burimeve ujore nuk njihet mirë. Sipas informacionit të disponueshëm, ujrat e sipërfaqes janë shumë të ndotur si rezultat i hedhjes/derdhjes së mbeturinave urbane dhe ujrave të ndotura industriale si dhe mbetje inerte.

2.5.3 Deti Adriatik

Vija bregdetare ne bashkine Divjake eshte rreth 25 km, duke nisur nga delta e lumit Shkumbin ne veri e deri ne grykederdhjen e lumit Seman. Nga kjo gjatesi afro11 km vije bregdetare perdoren per plazh per pushuesit ne sezonin e veres. Qe prej vitit 1990 eshte vene re nje fenomen interesant ku vija bregdetare eshte zhvendosur rreth 5 – 7 m per cdo vit. Kjo ka sjelle krijimin e kordonit te reres te quajtur spiaxho dhe depozitimin e shume aluvioneve dhe mbetje te ndryshme te sjella nga rrjedhat e lumenjve Shkumbin dhe Seman.

2.5.4 Gjendja në Mjedis

Tipari i veçantë i Bashkisë së Divjakës është fakti se ka një ndryshim të madh në numrin e njerëzve që jetojnë gjatë periudhave të ndryshme të vitit. Duke qënë se janë vlerësuar rreth 320,000 turistë/vit, ky fakt bën që edhe shërbimi të përshtatet në periudha të ndryshme sipas nevojave dhe fluksit të njerëzve. Kapacitetet turistike janë të kufizuara dhe në përgjithësi mungon infrastruktura e përshtatshme për kryerjen e shërbimeve publike, por kohët e fundit ka pasur investime në hotele dhe komplekse turistike, të pajisura me infrastrukturë dhe shërbime publike. Territori ndahet në 3 zona shërbimi për menaxhimin e mbeturinave;

- Zona 1 përfshin qytetin e Divjakës dhe zonën e plazhit,
- Zona 2 përfshin njësitë administrative Remas dhe Gradishtë
- Zona 3 përfshin njësitë administrative Tërbuf dhe Grabian

Në Bashkinë Divjakë janë raportuar tre depozitime (Gur, Gradisht dhe Grabian). Ndërkohë, vend- depozitimi i Tërbufit i përmendur në studimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit raportohet i mbyllur (DLDP & MoTE, 2018). Asnjë nga këto depozitime nuk i plotëson kriteret dhe standardet teknike ligjore.

Nga sa vihet re nga analiza e mësipërme, rezulton se asnjë nga vend-depozitimet në funksion nga Bashkia Divjakë nuk është në kushtet për të vazhduar aktivitetin pasi nuk plotësojnë kushtet dhe standardet minimale mjedisore duke krijuar ndotje dhe rrezik mjedisor për zonat e mbrojtura dhe tokat bujqësore të cilat janë në masë të madhe prezente në territorin administrativ. Për këtë qëllim duke ju referuar edhe dispozitave ligjore, konkretisht ligji Nr.10 463, datë 22.9.2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", neni 45, pika 3, gjatë realizimit dhe zbatimit të këtij plani duhet të merret në konsideratë planifikimi i një pike tranzitore për grumbullimin provizor të mbetjeve, ku mund të realizohet dhe një ndarje/selektim i mbetjeve të riciklueshme për të ulur kostot e transportit dhe depozitimit në landfillin/incineratorin rajonal.

2.6 Zhvillimi Urban

2.6.1 Qyteti Divjake

Bashkia e Divjakës ka 5 njësi administrative; Divjakë, Tërbuf, Grabjan, Gradishtë dhe Remas. Në territorin e saj, Bashkia Divjakë, përfshin një qytet dhe 36 fshatra me një sipërfaqe totale prej 309.58 km² dhe kufizohet nga Bashkia Rrogozhinë, Lushnje, Fier. Sipas regjistrimit të vitit 2011 (CENSUS), Bashkia ka 34,254 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil (RC) kjo Bashki ka një popullsi prej 53,372 banorë dhe një densitet prej 172,40 banorë / km². Veçantia për këtë Bashki është fakti se ka një ndryshim të madh në numrin e njerëzve që jetojnë gjatë periudhave të ndryshme të vitit. Nga konstatimet e banorëve, rezulton se shumë shtëpi përdoren vetëm gjatë sezonit të verës. Nga ana tjetër ky fakt është vlerësuar me një numër prej 320,000 turistësh/vit. Kapacitetet turistike janë të kufizuara dhe kohët e fundit ka pasur investime në hotele dhe komplekse turistike, të pajisura me infrastrukturë të përshtatshme, të cilat lejojnë edhe kryerjen e shërbimeve publike. Burimet financiare në dispozicion për çdo banor në Bashkinë e Divjakës janë nën mesataren kombëtare. Urbanizimi në BD ndjek e zbaton udhëzimet dhe VKM e qeverisë duke ruajtur standartet dhe kryesisht hapësirat e gjelberta dhe tokat bujqësore. Qyteti Divjake ka një infrastrukturë me të përmirësuar dhe kohët e fundit kjo ka ardhur duke u përmirësuar ende.

Zonat e banimit janë ato pjesë të territorit, të cilat kanë funksion kryesor sigurimin e njesive banuese të nevojshme për popullsinë e pritshme. Përdorimi i tokës në to, është për banesë si dhe shërbime e aktivitete tregtare në funksion të zonave të banimit.

Aktualisht, ne territorin e Bashkise Divjake siperfaqja e banesave kolektive eshte 90,202.6 m² dhe ajo e banesave individuale 908'188.4m², duke krijuar nje total prej 998,391m² ne rreth 10,289 objekte.

Keshtu, duke marre ne konsiderate. rritjen e popullsise ne banore per vitin 2031. duhet te plotesohen kriteret e siperfaqes minimale per banore. por gjithashtu nevojitet edhe nje cilesi me e larte e kushteve te banimit. Prandaj, perfshirja e standardeve te ndryshme te siperfaqeve te banimit si 25 m² /banore (minimale) dhe 40m²/banore, jo vetem qe do krijoje mundesi per zhvillime te ndryshme, por do te plotesoje kriteret ligjore per strehim. Ne pergjithesi ne strukturën aktuale te familjeve, ka ende diso breza te cilat bashkejetojne. Keto shtesa dhe familjet e krijuara si pasoje e rrijes natyrale te popullsise, do te kene nevojte per njesi te reja banimi. Keto njesi duhet te sigurojne kushtet e banesave sociale ose mbeshtetje nga shteti per kredi te bute apo sigurim qiraje.

2.6.2 Zonat Rurale

Megjithë perpjekjet e administrates per ta kontrolluar situaten ka nje tendence per ndertime ne tokat bujqesore ne pronesi te banoreve. Infrastruktura shkon drejt permiresimit dhe NJV si dhe fshatrat kane rruge te asfaltuara por ende ka fshatra te cilet kane problem sic jane lagjet e Gurit, ne Kryekuq, Njesia Rremas, apo Terbuf ne fshatrat Cerme Proshke e Cerme Shkumbin. Vihet re tendenca drejt shtepive nje e dy kateshe me konstrukt betoni e tulle me solete betoni dhe cati me tjegulla. Ne vitet aktuale ka nje frenim te investimeve nga emigrantet ne drejtim te ndertimit te banesave per shkak te shpopullimit si dhe renies se remitancave. Ne ndertimet e reja urbane nuk ka shume vend per hapesirat e gjelberta dhe kjo per shkak te mungeses se fondeve nga BD si dhe indiferentizmit te qytetareve ndaj ketij sherbimi. Kryesisht ne projektet e BD perfshihet rivitalizimi i hapesirave te gjelberta te krijuara dhe konceptuara qe ne krijimin e fshatrave dhe NJV nga koha e komunizmit. Siperfaqet e gjelberta jane kryesisht ato qe shoqerojne trotualet gjate ndertimit te rrugeve te reja por me se shumti te ristrukturimit te tyre apo nderhyrjeve te pjeseshme.

Komunikimi i fshatrave me BD sigurohet nepermejt transportit publik qe ka lehtesuar disi transportin e banoreve. Transporti privat mbetet prioritar per shkak te lehtesisë dhe shpejtesisë së shërbimit.

2.7 Trashëgimia Kulturore dhe Historike

Vlerat natyrore dhe ekologjike te Parkut Kombetar te Divjoke-Karavasta, troshegimia kulturore, tradita bujqesore, dhe peisazhet rurale, perbejne vlera ende te pa shfrytezuara. Duke marre ne konsiderate kete larmishmeri vlerash dhe duke synuar nje turizem te

qendrueshem dhe afatgjate. nepermjet zhvillimit te infrastrukturave akomoduese cilesore, larmishmerise se sherbimeve dhe nderthurjen e tyre, do te krijohet nje potencial real i zhvillimit te sektorit turistike, me game te gjere qe perfshin natyren, ekologjine, kulturen dhe traditen vendase.

Parku Kombetar Divjake-Karavasta eshte nje zone e mbrojtur ne zonen bregdetare te Shqiperise. Parku perbehet prej ekosistemeve komplekse te tilla si laguna, pylli, toka bujqesore, etj.. Ky park eshte shume i pasur ne biodiversitet dhe habitate natyrore. Zona qe perfshin parkun eshte pjese e Konventes se Ramsar-it qe prej vitit 1995.

Ishulli i Kulartit dhe Ishulli i Pelikanit: jone monumente natyrore pjese e Parkut Divjake-Karavosta, me vlera te medha per biodiversitetin e zones por dhe turizmin. Ishulli i Kulartit ndodhet ne grykderdhjen e lumit Shkumbin dhe ishulli i Pelikanit ne veriperendim te lagunes.

Zone arkeologjike: Kodrot e Divjakes deri ne afersi te Terbufit kane qene te banuara qe ne kohet e lashte nga fisi i Taulonteve. Kjo deshmohet nga prania e shume objekteve arkeologjike te gjeturo ne keto kodra, si varret e shumta te vendosura ne keto hapesiro. Nje hapje e kanalit kullues ne pjesen jugore te bashkise ne afersi te fshatit Mize dhe Xeng u gjeten tjegullo rrexulli. nje gozhde 12 cm, dy rrota me diameter 8 dhe 10 cm si dhe fragmente enesh te ndryshme.

Kisha e Shen Thanasit. eshte nje element i forte historik i bashkise Divjake, ndertimi i se ciles daton ne 1778en. kurse nje vit me pas, piktoret grabovare (çetiret) Gjergj dhe Joan Katro e mbushen ate me afreske. Te gjithë elementet e lartepemendur si natyrore, kulturore apo arkeologjike. Ashtu edhe elemente te tjere te veçante natyrore jo te permendur specifikisht.

Kapitulli 3. Problematikat lokale mjedisore në Bashkinë Divjakë

3.1 Kuadrit Institucional dhe Kapacitetet për zgjidhjen e problematikave lokale

DREJTORITE DHE SEKTORET E BASHKISE DIVJAKE

1. Njesia e Integritimit European
2. Sekretari i Përgjithshëm
3. Sektori i Auditit të Brendshëm
4. Sektori Juridik dhe Prokurimeve Publike
5. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
6. Sektori i Finances dhe Buxhetit
- 7 . Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme
8. Sektori i Mirëqenies Sociale dhe Përkujdesit Shoqëror
9. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit
10. Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore
11. Sektori i Regjistrimit dhe Procedurave
12. Sektori i Vlerësimit dhe Kontrollit
13. Drejtoria e Buqësisë, Mjedisit dhe Ujitjes
14. Sektori i Veterinarisë, Mjedisit dhe Pyjeve
15. Sektori i Ujitjes dhe Kullimit (Funksion i deleguar)
16. Sektori i Menaxhimit, Mbrojtjes Tokës dhe Aseteve
17. Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit
18. Inspektoriati i Policisë Bashkiake
19. Drejtoria e Kulturës, Sportit dhe Arsimit
20. Drejtoria e Rrugëve Rurale
- 21 Nëpunës Gjendjes Civile
- 22 Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (Funksion i deleguar)
- 23 Sektori i Shërbimeve Turistike

Kapitulli 4. Strategjia e advokimit

4.1. Shoqata Horizont EU

- Per 3 vite me radhe, 2018 - 2021 organizata **Horizont EU** ka dhene kontribut dhe mbeshtetje me baze materiale per Sherbimin Zjarrfikes te qytetit te Lushnjes, Divjakes si dhe stafit te AdZM prane PKDK. Projekti u realizua se bashku me Kishen Ungjillore Holande dhe Kishen Ungjillore Lushnje.
- Nga muaji Shkurt 2019 – Prill 2021 (nderprere per shkak te gjendjes se pandemise mbareboterore), organizata **Horizont EU** ne partneritet me organizaten **MEN – Mireqeverisja e Ekosistemeve Natyrore**, zbatuan projektin: Advokim per zhvillimin e ekoturizmit te qendrueshem duke respektuar mjedisin projekt i cili u mbeshtetet nga INCA Shqiperi me nje fond nga Bashkimi Europian i cili u zbatuar ne zonen e Parkut Kombetar Divjake-Karavasta.
- Nga data 13 Gusht 2020 e ne vijim, organizata **Horizont EU** udheheq rrjetin lokal prej 5 organizatash i quajtur: **“Vendi yne, e ardhmja e femijeve tane”** me qellim nxitjen e nje mjedisi te qendrueshem dhe krijimin e nje platforme te perbashket komunikimi si dhe nje strategji lobimi, advokimi dhe reagimi ndermjet OJF-ve te ketij rrjeti.
- Nga data 01 Tetor 2021 e ne vazhdim, organizata Horizont EU po zbaton si partnere projektin: “Rrjetezimi dhe Advokimi per Aksione Komunitarete Ruajtjes se Burimeve Natyrore Lokale” zbatuar nga INCA Albania me mbeshtetjen e Leviz Albania.

Vizioni i HEU

Ndertimi i nje shoqerie te kultururar e organizuar e perfaqesuar juridikisht, e afte per te ndertuar, shfrytëzuar e menaxhuar maksimalisht resurset e saj natyrore e agroturistike ne harmoni te perhershme me natyren dhe mjedisin!

4.2 Pervoja e Horizont EU në advokim – lobim

HEU ka nje experience te gjate dhe te fresket lidhur me BD pasi ka finalizuar me sukses nje project 2019 – 2021 me fokus “Advokimin per zhvillimin e ekoturizmit te qendrueshem duke respektuar mjedisin” pjese e projektit “Fuqizimi i OJF-e mjedisore te SHC-e per te promovuar mbrojtjen e Natyres ne Shqiperi, te financuar nga BE dhe zbatuar nga INCA. Projekti kishte ne fokus pikerisht advokimin per krijimin e nje maredhenie te qendrueshme dhe institucionale mes komunitetit, AdZM Fier me PKDK si dhe Bashkise Divjake per te ruajtur e menaxhuar sa me mire kete pasuri kombetare. Gjate realizimit te ketij projekti HEU dhe MEN dy organizata zbatuese forcuan lidhjet e meparshme me komunitetin, institucionin e bashkise dhe KB

Divjake si dhe aktore te rendesishem lokal.

4.3 Strategjia e advokimit e Horizont EU për periudhën 2022-2025

4.3.1 Çështjet kryesore që do të advokohen

Menaxhimi i qendrueshem i Lagunes se Karavastase

Menaxhimi i mbetjeve te ngurta e urbane

Kapitulli 5. Plani i advokimit

Vlerësimi dhe evidentimi i përfshirjes së komunitetit dhe shoqërisë civile në proceset e vendimmarrjes të menaxhimit të zones së mbrojtur PKDK dhe vlerave natyrore respektive lokale.

Ngritja e kapaciteteve të organizatave të rrjetit VYAFT mbi modelet e advokimit për një vendimmarrje dhe menaxhim sa më të qëndrueshëm të zones së mbrojtur dhe burimeve natyrore respektive lokale.

Hartimi i një metodologjie për mënyrat dhe modelet më të mira të advokimit dhe pjesëmarrjes publike.

- **Baza ligjore**
- Ligji për mjedisin
- Ligji për menaxhimin e burimeve ujore
- Strategjia kombëtare për menaxhimin burimeve ujore
- Ligji për vetëqeverisjen vendore
- Ligji për transparencën dhe informimin e publikut

- **Mesazhi i fushatës tuaj advokuese:**
- **Mbrojmë lagunën, mbrojmë jetën tonë!**
- **Grupi i aktorëve tek i cili do të shkojë mesazhi i fushatës tuaj advokuese**
- Bashkia Divjakës dhe Këshilli bashkiak
- Drejtoria e ujësjellës – kanalizimeve
- Këshilli I basenit të lumit Seman dhe Shkumbin/ZABU
- AMBU
- AKUMI
- AdZM Fier
- NGO/OSHC/komuniteti *dhe rekomanduar zgjidhjen e tij*
- **Aktivitetet:**
- Identifikimi i kompetencave ligjore dhe institucionale të bashkisë

- Rishikimi i udhëzuesve të bashkisë për menaxhimin e burimeve ujore (furnizimi me ujë dhe kanalizimet)
- Identifikimi i problemeve të menaxhimit të ujërave dhe zonës së mbrojtur natyrore
- Komunikimi me Këshillin bashkiak dhe Kryetarin e Bashkisë si dhe AdZM Fier për problematikën dhe mundësitë e zgjidhjes së situatës

Rekomandimet: do të dalin nga zbatimi i aktiviteteve në terren në bashkëpunim me drejtorite/specialistët e mjedisit dhe me struktura lokale në Bashkinë Divjakë

Kalendari i zbatimit të aktiviteteve dhe produktet që do të nevojiten për fushatën ose angazhimin e aktorëve kyç:

Aktiviteti	Koha e zbatimit	Materialet e nevojshme
Takim me gra keshilltare të bashkisë Divjake me qëllim orientimin e tyre dhe grupit me bazen ligjore	15 - 20 qershor 2022	Baza ligjore (pjesë të ligjit të printuara për orientim)
Takim me bordin e basenit si dhe info për planin e menaxhimit	25 - 30 qershor 2022	Baza ligjore mbi funksionimin e basenit dhe maredhenia e tij me bashkinë Divjake
Ndarje e këtij informacioni me anetare të rrjetit	5 – 10 korrik 2022	Material i printuar (raport) për secilin anetar të rrjetit
Ndertimi i një strategjie me mediat lokale apo kombëtare për publikimin e situatës deri në këtë fazë dhe nxitje për pjesëmarrje në konkurssin "Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore, transparenca dhe menaxhimi i zonave të mbrojtura dhe me vlera të pasurisë natyrore kombëtare".	15 – 20 korrik 2022	Propozimi i printuar dhe strategjia e propozuar për diskutim me gazetaret dhe mediat prezente
Reagimi i institucioneve përgjegjëse mbas publikimit	10 - 15 shtator 2022	

te situates nepermjet nje emisioni mediatik me perfshirje institucionesh		
Pergatitja e materialit advokues per adresim ne keshillin bashkiak	15 – 20 tetor 2022	
Emision mediatik ne mediat lokale mbi problemin dhe zgjidhjen qe ofrohet	10 – 20 nentor 2022	
Pergatitja e raportit permbylles per donatorin	20 – 30 nentor 2022	

Kapitulli 6. Media si instrument potencial për advokim

Instrumentat e përdorur për të siguruar advokim kanë qenë të ndryshme përfshi bashkëpunëtorët, lider komuniteti, drejtues fetare apo staf arsimor si dhe keshilltarrë bashkiakë apo biznese të zonës e operatore turistike dhe grupe interesi. Rrjetet sociale dhe mediat lokale së bashku me mediat kombëtare janë vlerësuar si mënyra më efektive të funksionimit për advokim nëpërmjet publikimit të problematikave dhe prioriteteve që kanë secili në punën e tyre. Jemi bazuar kryesisht në mediat lokale, kombëtare dhe rrjetet sociale.

Referuar eksperiencës dhe bashkëpunimeve të mëparshme me median si dhe aksesit në to, do të publikohet çdo aktivitet i organizuar. Në çdo rast duhet të publikohet aktiviteti dhe problemi të trajtohet me një informacion të përmbledhur ku të theksohet qëllimi dhe aktorët e përfshirë. Po kështu reagim i personave kompetentë si dhe përgjegjësitë e mara për të siguruar se bashku me kohën e reflektimit (reagimit apo nderhyrjes) për problemin që mbulon personin apo institucionin.

Mediat me të cilat do të bashkëpunojmë janë si më poshtë:

Nr	Emri mbiemër i gazetarit/res	Media e qe përfaqëson	Kontakti
1	Anila Sefa	Klan TV, ABC	+355693450648
2	Bledar Korreshi	Top Chanel	+355694442242
3	Kastriot Toshkollari	TVSH	+355692183775
4	Edi Halilaj	Radio Lushnja	+355689000955
5	Kozma Gjini	TV 4plus Lushnje	+355683193177
6	Aurel Sharka	Agronews.al	+355692681341
7	Yrjet Saliasi	Report TV	+355694244898
8	Julian Kasapi	Ora News	+355695721789
9	Marsela Topi	Apollon TV Fier	+355697241694
10	Fatos Daulle	Fax News	+355685875122

Kapitulli 7. Konkluzionet e raportit, rekomandime

Në lidhje me vend-depozitimet është e nevojshme të mbyllen të gjitha ato të cilat nuk respektojnë standardet minimale mjedisore. Ka 3 vend-depozitime aktive që janë të tepërta për sasinë e grumbulluar të mbeturinave (duhet konsideruar faktin se asnjë Bashki e Qarkut Fier nuk ka më shumë se 1vend-depozitim aktiv). Është urgjente mbyllja dhe rehabilitimi i vend-depozitimit të Gurit, i cili ndodhet në lagunën e Karavastase dhe ndotja e tij mjedisore ka efekt të menjëhershëm në turizëm por edhe në ekosistem. Duhet të vendoset për ndërtimin e një stacioni të transferimit të mbetjeve i cili duhet të plotësojë të gjitha kushtet për mbrojtjen e mjedisit duke qenë se kjo Bashki ka në territorin e saj zonë të mbrojtur dhe aktivitet bujqësor.

Shtojca:

Lista e shoqatave, Institucioneve, numra kontakt të personave përgjegjës.

nr	Emri i personit	Institucioni/OJF/OJQ/lider komuniteti	Kontakt tel/email
1	Shkelqim Bylykbashi	Horizont EU rrjeti VYAFT	+355692068229
2	Fadil Malko	Mireqeverisja Ekosistemeve Natyrore MEN rrjeti VYAFT	+355676721072
3	Ermelinda Myzeqari	Mendime dhe Inisiativa te Lira MIL rrjeti VYAFT	+355672881024
4	Jesuela Gega	Shoqata Kombetare ne Mbeshtetje te Grupeve Vulnerabel (Sh.K.N.M.G.V) rrjeti VYAFT	+355693020960
5	Josif Kruti	Shoqata e Vlleheve Arumune Divjake rrjeti VYAFT	+355682246533
6	Edi Halilaj	Radio Lushnja rrjeti VYAFT	+355689000955
7	Ardian Koci	AdZM Fier	+355698900540
8	Isuf Myrtaj	Bordi i Basenit Fier	+355698773005
9	Fredi Kokoneshi	Kr Bashkise Divjake	+355682008828
10	Ana Nako	Kr Keshilit Bashkiak Divjake	+355674795266
11	Denis Vogli	Agjensia Rajonale Mjedisit FR	+355684002281
12	Arben Velo	Sek Qarku Fier	+355692456755
13	Dilaver Zela	Drejtoria Sherbimeve Publike DI	+355696196092
14	Elbareta Nishica	Zyra e Urbanistikes DI	+355693458962
15	Llazar Staso	Zyra Arsimore Vendore DI	+355695711662
16	Avni Sula	Zyra e Bujqesise e Mjedisit DI	+355694800707
17	Altin Hila	Guida Divjake - Karavasta	+355693351895
18	Ristan Lala	Lider komuniteti DI	+355686381922
19	Sokol Krasniqi	Hoxhe, Komuniteti Mysliman DI	+355692075888
20	Pandi Sota	Prift, Komuniteti Ortodoks DI	+355692765743

21	Arjol Qose	Adm Njesia Vendore Gradisht	+355694408869
22	Sivana Keko	Adm Njesia Vendore Rremas	+355693703151
23	Berti Riku	Adm Njesia Vendore Grabjan	+355697444375
24	Fadil Balliu	Adm Njesia Vendore Terbuf	+355685529830